


01829



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, me datë 06.11.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR KORRIGJIMIN E AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE PËR NDËRTIMIN E KOMPLEKSIT ME NDËRTESE TË PËRKOHSHME AFARISTE”
05 NR. 350/02-17617/22 DT. 31.07.2023

I. Korrigjohet akti administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë të përkohshme afariste” 05 Nr. 350/02-17617/22 dt. 31.07.2023”, i kësaj drejtorie, i lëshuar në emër pronarit Adem Konjuhi nga fshati Prugoc-Komuna e Prishtinës, në procedurë të rishqyrtimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-71617/22 dt. 31.03.2022, sipas Vendimit Nr. A-237/22 dt. 31.01.2023 të MMPHI, për anulimin e Vendimit 05 Nr. 350/02-71617/22 dt. 23.08.2022 për refuzimin, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë afariste me karakter të përkohshëm dhe me destinim/përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës, restaurant dhe market, me etazhitet P+0, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, konkretisht në parcelën kadastrale 194-4 Z.K Prugoc.

Korrigjimi bëhet në:

- Renditjen e pikëve ashtu që pika “XI” zëvendësohet me pikën “X”, pika IX e përsëritur për të dytën herë, zëvendësohet me pikën “XI”, pika “VIII” e përsëritur zëvendësohet me pikën “XII”, pika “X” zëvendësohet me pikën “XIII” dhe pika “XI” e përsëritur zëvendësohet me pikën “XIV”.
- Pika “XI” sipas paragrafit të lartëshenuar do të zëvendësohet me pikën “X”, poashtu do të korrigjohet “Rreshti i nëntë dhe i dhjetë, dhe atë fjalia “Për paisje me këtë pëlqim, me kërkesë duhet t’i drejtoheni kësaj drejtorie, me dokumentacionin e nevojshëm, e cila përmes aktit përcjellës, do të procedohet, në kompetencë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural” do të zëvendësohet me “Për paisje me këtë pëlqim, me kërkesë duhet t’i drejtoheni kësaj drejtorie, me dokumentacionin e nevojshëm, e cila përmes aktit përcjellës, do të procedohet, në kompetencë në Drejtorinë e Bujqësisë”.

II. Ky vendim është pjesë e aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë të përkohshme afariste” 05 Nr. 350/02-17617/22 dt. 31.07.2023” dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, me aktin administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë të përkohshme afariste 05 Nr. 350/02-17617/22 dt. 31.07.2023”, i ka caktuar kushtet ndërtimore aplikuesit Adem Konjuhi nga fshati Prugoc-Komuna e Prishtinës, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesë afariste me karakter të përkohshëm dhe me destinim/përmbajtje: Pikë e shitjes së derivateve të naftës, kafene dhe market, me etazhitet P+0, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, konkretisht në parcelën kadastrale 194-4 Z.K Prugoc.

Faqe 1 prej 2

Në ndërkohë, ky organ ka vërejtur se në aktin administrativ të referuar, kanë rrjedhur disa gabime teknike, gjegjësisht në dispozitiv të të njëjtit akt, është shënuar gabim "Renditja e pikëve ashtu që pika "XI" zëvendësohet me pikën "X", pika IX e përsëritur për të dytën herë, zëvendësohet me pikën "XI", pika "VIII" e përsëritur zëvendësohet me pikën "XII", pika "X" zëvendësohet me pikën "XIII" dhe pika "XI" e përsëritur zëvendësohet me pikën "XIV". Te pika "XI" e që do të zëvendësohet me pikën "X", poashtu ka rrjedhë një gabim teknik në rreshtin e nëntë dhe të dhjetë dhe korrigjimi do të bëhet ashtu që fjalia "Për paisje me këtë pëlqim, me kërkesë duhet t'i drejtoheni kësaj drejtorie, me dokumentacionin e nevojshëm, e cila përmes aktit përcjellës, do të procedohet, në kompetencë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural" do të zëvendësohet me "Për paisje me këtë pëlqim, me kërkesë duhet t'i drejtoheni kësaj drejtorie, me dokumentacionin e nevojshëm, e cila përmes aktit përcjellës, do të procedohet, në kompetencë në Drejtorinë e Bujqësisë". Prandaj sipas detyrës zyrtare, pas rishikimit të aktit të referuar dhe konstatimit për gabimet e rrjedhura, të njejtat korrigjohen, sipas përshkrimit në pikën I të dispozitivit të këtij akti administrativë.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesit/Investitorit, në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-71617/22 dt. 31.03.2022, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-71617/22 DT. 06.11.2023**

Zyrtari,

Mejrushe Sejfullahu



Udhëheqësi i Sektorit

Me Z. No. 350/02-71617/22

Drejtoria e Urbanizmit

Komuna e Prishtinës

Republika e Kosovës

Republika e Kosovës

Republika e Kosovës